

Burimet: SHFDUÇK, *Feniksët...11, 11-12; Lista e dëshmoreve të brigadës 138 Agim Ramadani*, www.kosharja99.info, FDH-19099; deklarata A.L., FDH-31936.

Bejzat (Zenel) Krasniqi

(28.11.1975, shqiptar nga Negroci/Negrovce, komuna e Glllogocit/Glogovac, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Bejzati aderoi në UÇK në muajin qershor të vitit 1998. Në datën 12.06.1998, ai me një grup pjesëtarësh të UÇK-së kanë shkuar për një ngarkesë të re armatimesh në Shqipëri. Në datën **17.06.1998**, në afërsi të **Koshares/Košare**, grupi ka hasur befasisht në pritën e forcave serbe. Duke tentuar që të shpëtonin nga të shtënat, pjesëtarët e grupit u shpërndanë në të gjitha anët, përpos Bejzatit, të cilin forcat serbe e qëlluan menjëherë duke e lënë të vdekur në vend. Pas përfundimit të luftës, në datën 14.10.2004, familjarët e kanë marrë njoftimin nga Instituti për Mjekësinë Lijore në Rahovec/Orahovac se ishin identifikuar mbetjet mortore të Bejzatit. Gjatë pranimit të mbetjeve të tij mortore, familjarët kanë mësuar se trupi i tij ishte zbuluar në varrezën masive në Landovicë/Landovica [Prizren]. Mbetjet mortore të Bejzatit u varrosën në varrezat në Negroc/Negrovce, më 25.10.2004.

Burimet: deklarata F.K, FDH-31834; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Florian (Musa) Kurti

(3.07.1988, shqiptar nga Smolica/Smonica, komuna e Gjakovës/Đakovica, nxënës)

Floriani, 10 vjeç, shkonte në klasën e katërt të shkollës fillore në **Smolicë/Smonica**. Jetonte me prindërit, Musën dhe Xheven, vëllezërit, motrat, gjyshen, axhën dhe familjen e tij. Për shkak të sulmeve të shpeshta të forcave serbe, nga mesi i qershorit të vitit 1998, axha i tij Muhameti ka kaluar me familjen në Nivokaz. Në mëngjesin e datës **19.06.1998**, forcat serbe kanë nisur të gjuanin me artileri mbi Smolicën/Smonica nga drejtimi i Popocit/Popovac. Forcat serbe ishin të pozicionuara në vendin e quajtur *Shpati i Zeqirit/Zeqirov vrh*. Pas di-

te, situata u qetësua përkohësisht dhe nëna e Florianit shkoi te një fqinje për një kafe, ndërsa ai mbeti me babanë, vëllain Hajdarin dhe motrën Liridonën. Shikonte për dritare. Në çastin kur u largua nga dritarja në dhomën depërtoi një cifël e predhës minahedhëse. Floriani u plagos rëndë në shpinë, ndërkaq Hajdari dhe Liridona u plagosën vetëm lehtë. Me fëmijët që ishin të shtrirë mbi një qerre kuajsh, Musa u nis menjëherë drejt spitalit të UÇK-së në Dobrosh/Dobroš, por Floriani dha shpirt në hyrje të këtij fshati. Në mbremje të së njëjtës ditë, atë e varrosën në një fushë, në afërsi të shtëpisë së familjes Kurti.

Burimet: deklarata M.K, FDH-32442; deklarata SH.H., FDH-32444.

Rexhep (Dervish) Ademi

(1936, shqiptar nga Batusha/Batuša, komuna e Gjakovës/Đakovica)

Rexhepi jetonte me vëllain Dervishin dhe familjen e tij në **Batushë/Batuša**. Në datën 1.06.1998, policia serbe hyri në fshat. Një grup policësh erdhi edhe te shtëpia e Dervishit dhe Rexhepit. Urdhëruan që të gjithë të braktisnin fshatin. Rexhepi dhe të gjithë familjarët e tij iu bashkëngjitën fshatarëve tjerë, të cilët u detyruan që përmes malit të niseshin për në Shqipëri. Në dalje të fshatit, Rexhepi vendosi që të kthehej në shtëpi. Ishte kjo hera e fundit që familjarët e shihnin të gjallë. Dy muaj më vonë, i vëllai ka dëgjuar në *Radio Tiranë* se Rexhepin në oborrin tij e kishin pushkatuar policët serbë më **20.06.1998**, dhe se ai u varros në varrezat e Gjakovës/Đakovica. Mbetjet mortore të Rexhepit u rivarrosën në varrezat e Batushës/Batuša, në muajin gusht të vitit 2000.

Burimi: deklarata D.A, FDH-15888.

Tahir (Rame) Memia

(25.07.1962, shqiptar nga Myhejani, [Shqipëri], bujk, tre fëmije, pjesëtar i UÇK-së)

Mehmet (Ramadan) Dizdari

(8.10.1972, shqiptar nga Shkëlzeni [Shqipëri], pjesëtar i UÇK-së)

Mehmeti ka qenë i papunë. Në muajin maj